


01-1995



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 21, 44, 45 & 140 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës nr.110-391 dt. 25.02.2010, UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02 – 203396/20 dt.03.11.2020 të kërkuësve/pronarëve, "Pozhegu Brothers" sh.p.k., Rustem Krasniqi, Driton Rama, Memedali Nazifi, Faruk Nazifi, Nazmi Jusufi, Sejdi Rexhepi, Arment Dërmaku, Lulzim Rustolli, Hajrullah Etemi, Kudret Arifi, Luan Kastrati, Shpresa Etemi nga Prishtina dhe Investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksi "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "D1" me 3B+S+P+10, "D2" me 2B+S+P+7 dhe "D3" me 2B+P+7 në kuadër të pjesës së Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative me datë 27.01.2022 merr këtë:

V E N D I M

CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuësve/pronarëve, "Pozhegu Brothers" sh.p.k., Rustem Krasniqi, Driton Rama, Memedali Nazifi, Faruk Nazifi, Nazmi Jusufi, Sejdi Rexhepi, Arment Dërmaku, Lulzim Rustolli, Hajrullah Etemi, Kudret Arifi, Luan Kastrati, Shpresa Etemi nga Prishtina dhe Investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksi "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "D1" me 3B+S+P+10, "D2" me 2B+S+P+7 dhe "D3" me 2B+P+7 në kuadër të pjesës së Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, nr. 825-1, 825-4, 825-5, 826-13, 827-17, 827-18, 827-19, 827-25, 827-30, 830-3, 830-4, 830-5, 830-6, 830-7, 830-16, 1759-2 & 1759-3 ZK Matiçan, me trajtim përmes kompensimit / shpronësimit me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës kadastrale nr. 825-1, 827-25, 827-30, 830-16 & 1759-2 ZK Matiçan, sipas projekt propozimit - Projektit konceptual dhe "zgjidhjes urbane";

II. Lokacioni / parcelat për të cilat caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të:

- Planit Rregullues "Mati 1", miratuar me Vendimin për miratimin e propozim planit rregullativ për Lagjen "Mati 1" në Prishtinë 01nr.35 – 14451 dt.21.06.2005, dhe ndryshuar me Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-642 dt. 01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01nr.031-1678 dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë të jetë "Ndërtim i lartë";

- Vendimi 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane",

Kërkuësit, me Informatë nga Planit Rregullues "Mati 1" – PZHU, me referencë 04nr.350/01 – 174306/20 dt.28.10.2020, lëshuar nga DPSZHQ, janë informuar me kriteret, parametrat urban dhe kushtet për ndërtim në lokacion.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelave, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve

- nr.825-5; S=38m ² ;	Lulzim Rrustolli;		"Arë e klasit 3";
- nr.826-13; S=66m ² ;	Luan Kastrati;		"Arë e klasit 3";
- nr.827-17; S=389m ² ;	Kudret Arifi;		"Arë e klasit 3";
- nr.827-18; S=354m ² ;	Lulzim Rrustolli;		"Arë e klasit 3";
- nr.827-19; S=28m ² ;	Hajrullah Etemi;		"Arë e klasit 3";
- nr.827-25; S=632m ² ;	Shpresa Etemi;		"Arë e klasit 3";
- nr.827-30; S=302m ² ;	Luan Kastrati;		"Arë e klasit 3";
- nr.830-3; S=400m ² ;	Rrustem Krasniqi ;		"Arë e klasit 3"
- nr.830-4; S=200m ² ;	Driton Rama, Pozhegu Brothers;		"Arë e klasit 3";
- nr.830-5; S=400m ² ;	Memedali Nazifi;		"Arë e klasit 3";
- nr.830-6; S=400m ² ;	Pozhegu Brothers, Faruk Nazifi;		"Arë e klasit 3";
- nr.830-7; S=600m ² ;	Nazmi Jusufi, Sejdi Rexhepi;		"Arë e klasit 3";
- nr.830-16; S=400m ² ;	Arment Dërmaku;		"Arë e klasit 3";
- nr.1759-2; S=220m ² ;	Pozhegu Brothers;		"Arë e klasit 3";
- nr.1759-3; S=144m ² ;	Pozhegu Brothers;		"Arë e klasit 3";

Totali: S=4,937m²;

- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.830-7, 830-5, 830-4, 830-3, 827-18, 827-17, 827-25 ZK Matiçan, përfshihen ndërtesa individuale banimore me etazhitet, B+P+1,P+1, B+P+NK, P+1+NK, kurse parcelat tjera janë të zbrazëta, kurse nr.1759-2 &1759-3 ZK Matiçan është infrastrukturë rrugore në pronësi private;
- Është tokë urbane me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë;
- Terreni ka pjerrtësi të konsiderueshme nga drejtimi Veri – Jug me një disnivel ~7.80m';
- Qasja në parcela - kompleks është planifikuar përmes rrugës ekzistuese e cila është edhe rrugë e planit rregullues urban "Konstadin Kristoforidhi";
- Bazuar në incizimin e gjendjes faktike të Bllokut urban , "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, punuar nga Gjeodet i Licencuar Burim Halilaj, me licencë nr.195, konstatohet se blloku është realizuar mbi masën prej 50%, sipas kriterëve të planit rregullues urban;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50m' ka ndërtesa ekzistuese si: shtëpi individuale banimore dhe ndërtesa shumë banesore.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor dhe rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për ndërtimin e Kompleksi "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "D1" me 2B+S+P+10, "D2" me 2B+S+P+7 dhe "D3" me 2B+P+7 në kuadër të pjesës së Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, janë:

- Organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhiteti i ndërtesës, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distancat e ndërtesës nga kufiri i parcelës, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit-"zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit të kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, planifikohet të ndërtohen Kompleksi shumë banesore & afariste – "Froni i Matit", me sipërfaqe ndërtimore, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleksi "Froni i Matit" me ndërtesa shumëbanesore & afariste –Ndërtesa "D1", "D2"&"D3".

Ndërtesa "D1" – S=10,498.07m² / 7,182.24m²,mbi tokë + 3,315.83m²,nën tokë /,
Etazhitet: 3B+S+P+10,

Ndërtesa "D2" – S=3,790.64m² / 2,711.75m²,mbi tokë + 1,078.89m²,nën tokë /,
Etazhitet: 2B+S+P+7,

Ndërtesa "D3" – S=4,659.40m² / 3,355.96m²,mbi tokë + 1,303.44m²,nën tokë /,
Etazhitet: 2B+P+7,

Totali "D1", "D2" & "D3": S=18,948.11m² / 13,249.95m², mbi tokë + 5,698.16m², nën tokë /

- Parcelat dhe pjesët e parcelave për realizimin e Kompleksit "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste , të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.825-1; $S=155m^2$;
- nr.825-4; $S=15m^2$;
- nr.825-5; $S=38m^2$;
- nr.826-13; $S=13m^2$;
- nr.827-17; $S=389m^2$;
- nr.827-18; $S=354m^2$;
- nr.827-19; $S=28m^2$;
- nr.827-25; $S=48m^2$;
- nr.827-30; $S=135m^2$;
- nr.830-3; $S=400m^2$;
- nr.830-4; $S=200m^2$;
- nr.830-5; $S=400m^2$;
- nr.830-6; $S=400m^2$;
- nr.830-7; $S=600m^2$;
- nr.830-16; $S=362m^2$;
- nr.1759-2; $S=0.00m^2$;
- nr.1759-3; $S=144m^2$;

Sipërfaqja totale: $S=3,681m^2$;

- Parcelat dhe pjesët e parcelave për realizimin e Kompleksit "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.825-1; $S=146m^2$;
- nr.825-4; $S=0.00m^2$;
- nr.825-5; $S=0.00m^2$;
- nr.826-13; $S=0.00m^2$;
- nr.827-17; $S=0.00m^2$;
- nr.827-18; $S=0.00m^2$;
- nr.827-19; $S=0.00m^2$;
- nr.827-25; $S=165m^2$;
- nr.827-30; $S=167m^2$;
- nr.830-3; $S=0.00m^2$;
- nr.830-4; $S=0.00m^2$;
- nr.830-5; $S=0.00m^2$;
- nr.830-6; $S=0.00m^2$;
- nr.830-7; $S=0.00m^2$;
- nr.830-16; $S=38m^2$;
- nr.1759-2; $S=220m^2$;
- nr.1759-3; $S=0.00m^2$;

Sipërfaqja totale: $S=736m^2$;

- Parcelat dhe pjesët e parcelave që nuk trajtohen për realizimin e Kompleksit "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste, janë:

- nr.825-1; $S=48m^2$;
- nr.825-4; $S=0.00m^2$;
- nr.825-5; $S=0.00m^2$;
- nr.826-13; $S=53m^2$;
- nr.827-17; $S=0.00m^2$;
- nr.827-18; $S=0.00m^2$;
- nr.827-19; $S=0.00m^2$;
- nr.827-25; $S=419m^2$;
- nr.827-30; $S=0.00m^2$;
- nr.830-3; $S=0.00m^2$;
- nr.830-4; $S=0.00m^2$;
- nr.830-5; $S=0.00m^2$;
- nr.830-6; $S=0.00m^2$;
- nr.830-7; $S=0.00m^2$;
- nr.830-16; $S=0.00m^2$;

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë për banim shumë banesor & afarizëm me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj., (sipas projekt propozimit);
- Etazhite maksimal i lejuar për të Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1", është IV – VIII etazhe, kurse sipas PZHU-së VII - IX etazhe mbi tokë;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale/parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën - gabaritin e përdhësës ose suteranit, bazuar në Planin Rregullues "Mati 1", konfirmuar me Vendimin 14 nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane", lejohet max.40% dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=3,681 \times 0.4(40\%)=1,472.40 \text{ m}^2$;
 $S=1,461.71 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale / parcelës ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi e parcelave brenda vijës rregulluese, bazuar në Planin Rregullues "Mati 1" konfirmuar me Vendimit 01nr.031-185481 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin të bodrumit lejohet max.60%, dhe sipërfaqja është:
 $S=3,681 \times 0.6(60\%)=2,208.60 \text{ m}^2$;
 $S=2,183.34 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ) është min.40%, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, bazuar në Planin Rregullues "Mati 1" konfirmuar me Vendimit 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane" dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=3,681 \times 0.4=1,472.40 \text{ m}^2$;
 $S=1,145 + 379 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit 30% në parter dhe 10% në kulme /
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Mati 1" është **3.0**.
Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - suteran, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – bodrume, dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=3,681 \times 3.0=11,043 \text{ m}^2$,
 $S=13,249.95 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit konceptual duke llogaritur edhe kompensimin / shpronësimi /
- Bazuar në Vendimin 01nr.400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private deri në 20%, e përfshirë në hapësirë të paraparë për interes publik, me koeficient të ndërtimit, kjo sipërfaqe mund të shtohet për $S=736/3,681 \times 100=19.99\%$, gjegjësisht sipërfaqja ndërtimore totale do të jetë. Sipas kalkulimit kompensimi do të jetë **$S=736 \times 3.0=2,208.00 \text{ m}^2$** , andaj sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore e lejuar për ndërtesë është:
 $S=11,043 + 2,208=13,251 \text{ m}^2$;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për shkaqe të kursimit dhe eficiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e Planit Rregullues "Mati 1", "*sipërfaqja e lirë përreth objektit duhet të pozicionohet në kuadër të "ngastrës"- brenda parcelës kadastrale, dhe për të siguruar dritë dhe ajër të mjaftueshëm*", kjo sipërfaqe e lirë duhet të jetë $0.4 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), për të mundësuar ndriçim direkt të mjaftueshëm natyror, nëpërmjet hapjeve në fasadë për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore, etj), dhe kjo sipërfaqe e lirë duhet ti referohet kufirit të parcelës, e cila distancë e njëjtë do të vlejë edhe për hapësirën mes dy ndërtesave të kompleksit;
- Distanca anësore e ndërtesës pa hapje në fasadë apo me hapje të kthinave sekondare dhe komunikimit (banja, wc, depo, shkallë, etj.) të jetë min. 3.0m. Nëse sigurohet pëlqimi i vërtetuar

nga pronari/pronarët e parcelave fqinje, kjo distancë mund të zvogëlohet apo mund të ndërtohet në kufi të parcelave, por në atë rast nuk lejohet hapje në ato fasada;

- Ngritja e nivelit të përdhese nga niveli i terrenit të jetë max. 30cm për pjesën afariste dhe max. 1.20m për pjesën banimore;
- Për çdo njësi banesore dhe çdo 30m²/1VP të neto sipërfaqes së afarizmit, të planifikohet një vend parkim, në kuadër të ndërtesës apo kompleksit;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe parkingjet e jashtme, rrugë të brendshme të kompleksit, si dhe shtigjet & trotualet;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

Kushtet ndërtimore për rregullimin e hapësirës dhe hartimin dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor përveç tjerash, të jenë edhe sipas normave teknike të "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore".

V. Ndarja / parcelimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 825-1, 826-13, 827-25, 827-30 & 830-16 ZK Matëan, të bëhet sipas manualit të punuar nga gjeodeti i licencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195.

Kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes punuar nga komania gjeodezike e licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të realizohet në fazën pas miratimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në Planin e situacionit - "zgjidhja urbane", "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje punuar nga gjeodeti i licencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Bashkimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, 825-1, 825-4, 825-5, 826-13, 827-17, 827-18, 827-19, 827-25, 827-30, 830-3, 830-4, 830-5, 830-6, 830-7, 830-16 & nr.1759-3 ZK Matëan, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, bazuar në Planin e situacionit – "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planit Rregullues "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit të bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planit Rregullues "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim punuar nga gjeodeti i Licencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

VII. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës kadastrale nr. 825-1 me S=146m², nr.827-25 me S=165m², nr.827-30 me S=167m², nr.830-16 me S=38m² & nr.1759-2 me S=220m², ZK. Matëan, me sipërfaqe totale prej S=736m², të përfshira në hapësirë publike të planifikuara – "rrugë", do të llogaritet bazuar në koeficientin ndërtimor të Planit Rregullues "Mati 1" që është 3.0, dhe kompensimi/shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore do të jetë bazuar në kalkulimin si në vazhdim: $S=736/3681 \times 100=19.99\%$, andaj e tërë sipërfaqja mund të shpronësohet, dhe sipas kësaj, kompensimi do të jetë $S=736 \times 3.0=2,208m^2$. Andaj pronarët për pjesën e parcelës të lartë cekura e S=736m² ($3681 \times 0.2=736.20$ -Si rezultat i kompensimit deri në 20% të pjesës jashtë Vijës rregullative që paraqet produktin e pjesës brenda vijës rregulluese me S=3681m² me 20% e saj) do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore prej $S=2,208m^2$.

Procedurë e kompensimit / shpronësimit me sipërfaqe ndërtimore të pronës private, do të realizohet pas caktimit të kushteve ndërtimore, gjegjësisht para aplikimit për leje ndërtimore, me

për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orto-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos" - Ngrohitorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor / projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën VI., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo-stacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend-ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

Dokumentet të dorëzohen në tërësi sipas shtojcës "Dokumente teknike të nevojshme për aplikacionet për leje ndërtimore", e cila i është bashkangjitur këtyre Kushteve Ndërtimore.

X. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të

procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr. 825-1, 825-4, 825-5, 826-13, 827-17, 827-18, 827-19, 827-25, 827-30, , 830-3, 830-4, 830-5, 830-6, 830-7, 830-16 & 1759-3 ZK. Matičan, bazuar në certifikatat e njësive kadastrale, janë të evidentuar me lloj të shfrytëzimit si tokë bujqësore me klasë të kualitetit "Arë e klasit 3", "Hendek ujqor" & "Rajon ujqor" paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Planit i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej **S=3,681m²**. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XII. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për leje rrënimi për rrënimin e ndërtesave ekzistuese në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit, aplikuar me kërkesë të veçantë.

XIII. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me të drejtë vazhdimi edhe për një (1) vit tjetër, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së kushteve ndërtimore.

A r s y e t i m

kërkesën 05nr.350/02 – 203396/20 dt.03.11.2020, kanë kërkuar nga kjo drejtori për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksi "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "D1" me 3B+S+P+10, "D2" me 2B+S+P+7 dhe "D3" me 2B+P+7, në lokacionin e përshkruar në paragrafët I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 203396/20 dt.03.11.2020, dhe plotësuar me shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02 – 203396/20/3 dt.22.04.2021, 05nr.350/02 – 203396/20/4 dt.07.05.2021, 05nr.350/02 – 203396/20/5 dt.04.06.2021, 05nr.350/02 – 203396/20/5 dt.04.08.2021, 05-350/02-203396/20/6 dt. 08.12.2021 & 05-350/02-203396/20/7 dt. 17.01.2022 dhe gjatë fazës së trajtimit të kërkesës, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

